


Statistikat e Peshkimit 2023

Tiranë, më 25 Qershor 2024: Në vitin 2023, zënia e peshkut nga të gjitha kategoritë ujore, ka qenë 19.338 tonë nga 17.799 tonë që ishte në vitin 2022, duke shënuar një rritje me 8,65 %.


Fig. 1 Zënie nga peshkimi, gjithsej (tonë)



Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Llogaritje INSTAT

Struktura e zënieve sipas kategorive ujore: Kategoritë ujore të peshkimit janë: det, bregdet, laguna, ujëra të brendshme, akuakulturë dhe molusqe. Kategoritë kryesore që zënë përqindjen më të lartë të peshkimit janë, “Akuakultura” me 47,27 % dhe “Ujërat e brendshme” me 25,12 %, pasuar nga peshkimi “Detar” me 22,02 %, ndaj prodhimit gjithsej.

Fig. 2 Struktura e zënieve nga peshkimi sipas kategorive ujore, 2023 (%)



Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Llogaritje INSTAT

Për publikim 25/06/2024

Ndryshimet vjetore të zënieve sipas kategorive ujore

Në vitin 2023, rritjen më të madhe, e ka shënuar kategoria “Ujërat e brendshme” me 43,39 % të zënieve gjithsej, krahasuar me një vit më parë, ndjekur nga kategoria “Aquakultura” me 14,46 %. Kategoria ujore “Molusqe” ka pësuar rënie me 79,83 % në vitin 2023, krahasuar me një vit më parë.

Tab.1 Zëniët nga peshkimi sipas kategorive ujore (tonë)

Emërtimi	2021	2022	2023
Kategoritë ujore			
I Gjithsej zëniei (1+2+3+4)	9.842	8.891	10.011
1 Detar	5.192	4.319	4.259
2 Bregdeti	832	984	676
3 Laguna	275	200	218
4 Ujërat e brendshme	3.544	3.388	4.858
II Akuakultura	8.068	7.986	9.141
III Molusqe	593	922	186
Gjithesej Peshkimi (I + II +III)	18.503	17.799	19.338

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Llogaritje INSTAT

Zëniët sipas specieve kryesore

Në vitin 2023, për sa i përket kategorive ujore, det, bregdet dhe laguna, specia e cila ka rezultuar me përqindjen më të madhe të zënë është “Karkaleci i thellësisë” me 19,42 % ndaj zënieve gjithsej, pasuar nga “Merluc” me 15,17 % dhe “Sardele” me 11,51 %. Përsa i përket zënieve në ujërat e brendshme, specia “Karas” zë përqindjen më të madhe të zënieve gjithsej me 25,77 % pasuar nga “Krap” me 22,07 % dhe specia “Skortë” me 14,99 %.

Tab.2 Zëniët sipas specieve kryesore dhe kategorive ujore, viti 2023

Speciet Detare, Bregdetare, Lagunë	Sasia në tonë
Karkalec i thellësisë	999
Açuga	485
Merluc	780
Sardele	592
Barbun	292
Kallamar	143
Skampi	89
Ton	264
Oktapod	146
Moskardin	93
Specie të tjera	1260
Speciet e Ujërave të brendshme	Sasia në tonë
Karas	1252
Skortë	728
Krap	1072
Qefull	472
Ballgjer i bardhë	325
Perka ose Shamak	294
Specie të tjera	715

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Llogaritje INSTAT

Flota detare


Në vitin 2023, janë 811 subjekte të licensuara për të ushtruar aktivitetin e peshkimit. Flota vepron pothuajse plotësisht në Nën-Zonën Gjeografike (NZGJ) 18 (Adriatiku i Jugut). Gjatë vitit 2023 janë regjistruar 27 subjekte më shumë se një vit më parë.

Flota detare sipas porteve të peshkimit

Në vitin 2023, porti me numrin më të madh të anijeve të licensuara është porti i Durrësit me 36,87 % të flotës së përgjithshme, porti i Vlorës ka 30,83 % të numrit të përgjithshëm të flotës, pasuar nga porti i Sarandës me 15,04 %.

Portet e peshkimit me përqindjet më të vogla të subjekteve të licensuara për peshkim janë ato të Lushnje-Fier me 2,22 %, Himarës me 1,60 %.

Fig. 3 Shpërndarja e flotës detare sipas porteve të peshkimit 2023 (numër anijesh)



Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Llogaritje INSTAT

Flota detare sipas llojit të anijes

Flota detare shqiptare nisur nga qëllimi i anijes ndahet në gjashtë lloje të ndryshme anije peshkimi. Pjesa më e madhe e flotës sonë është e përbërë nga anije me njica me 71,64 % si dhe anije peshkimi me tërheqe (fundore dhe pelagjike) me 24,54 %, të cilat përdoren kryesisht për të peshkuar peshqit fundorë. Pjesa tjetër janë anije shumëpërdorimshe dhe anije për qëllime të tjera.

Tab. 3 Flota detare sipas llojit të anijes(nr)

Emërtimi	2021	2022	2023
Shpërndarja e flotës sipas llojit të anijes			
Me tërheqje (fundore dhe pelagjike)	194	196	199
Me mrezha	-	-	-
Me koshilok	10	10	10
Me draga hidraulike	5	5	5
Me njica	525	556	581
Anije shumëpërdorimshe	18	17	16
Gjithsej	752	784	811

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Llogaritje INSTAT

Prodhimi i rasateve

Një fokus të veçantë po i kushtohet prodhimit të rasateve si: Trofta Ylber, Koran dhe Krap si një vëmendje e shtuar dhe ndihmesë për ruajtjen e biodiversitetit. Në vitin 2023, u prodhuan dhe hodhën në liqenin e Ohrit 3,30 milion rasate të Troftës Ylber, 1,80 milion rasate të Koranit dhe 1,15 milion rasate Krap.

Tab. 4 Prodhimi i rasateve (milionë rasate)

Emërtimi	2021	2022	2023
Koran	1,4	1,6	1,8
Krap	1,0	1,6	1,2
Ballgjërë i bardhë	1,3	0,5	0,4
Ballgjërë Laraman	0,2	0,2	0,1
Amur i bardhë	0,5	0,2	0,2
Pëllëmbëz	0,1	0,0	0,0
Trofta Ylber	0,0	9,0	3,3

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Llogaritje INSTAT

Metodologjia

Statistikat e peshkimit për vitin 2023, mbështeten në informacionin administrativ, të mbledhur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i tyre mbështetet në legjislacionin vendas si dhe duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së:

- Ligj Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”;
- Ligj Nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 – 2026”;
- Regullorja (EC) Nr. 216/2009 mbi “Statistikat e Zënieve të Peshkut, për peshkimin në zona të caktuar përveç Atlantikut të Veriut”;
- Regullorja (EC) Nr. 762/2008 mbi “Statistikat e Akuakulturës”.

Informacioni statistikor lidhur me peshkimin dhe akuakulturën grumbullohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duke u mbështetur në metodikën e GFCM (General Fisheries Commission for the Mediterranean) për grumbullimin e të dhënave bazuar në segmentet e flotës së peshkimit, grumbullimin e logbook-eve nga anijet, intervistat me operatorët e akuakulturës, etj. Të dhënat për zënien e peshkut grumbullohen sipas kategorive ujore dhe në nivel vendi.

Variablat kryesore grupohen në këto kategori:

- *Zënie peshku sipas kategorive ujore:*
 - a. Detar;
 - b. Bregdet;
 - c. Laguna;
 - d. Ujëra të brendshme;
 - e. Akuakultura.
- *Zëniet sipas specieve kryesore:*
 - a. Açuga;
 - b. Karkalec i thellësisë;
 - c. Merluc;
 - d. Sardele;
 - e. Etj.

- *Flota detare sipas porteve të peshkimit:*
 - a. Durrës;
 - b. Vlorë;
 - c. Saranda;
 - d. Shëngjin;
 - e. Himara;
 - f. Lushnje –Fier.

- *Flota Detare sipas llojt të anijes:*
 - a. Me tërheqje (fundore dhe pelagjike);
 - b. Me mrezha;
 - c. Me koshilok;
 - d. Me draga hidraulike;
 - e. Me njica;
 - f. Anije shumëpërdorimshe.

Përkufizime:

Peshkimi

Të dhënat zënie peshku (prodhim peshku dhe akuakultura) grumbullohen sipas kategorive ujore.

Kategoritë ujore të peshkimit janë: peshkimi detar, bregdet, laguna, ujëra të brendshme, akuakulturë dhe molusqe.

Peshkimi detar: Përfshin të gjitha të dhënat e aktivitetit të flotës së peshkimit dhe kapacitetin prodhues të sipërfaqeve të ndryshme të peshkimit.

Kapaciteti i peshkimit

Është sasia e peshkut që mund të merret nga një njësi peshkimi.

Zënie peshku

Të dhënat i referohen sasisë së zënies të të gjitha llojeve të specieve detare (të peshkut, krustance, molusqe etj), specieve të ujërave të ëmbla (lumenj, liqene, ujëmbledhësa, akuakulturë).

Akuakultura

Është rritja e peshkut në kushte artificiale, në të cilin përfshihen: rritje peshku me anë të rasateve, molusqe dhe krustance

Flota

Është numri total i anijeve të peshkimit që shfrytëzon një burim të caktuar. Flota vepron pothuajse plotësisht në Nën-Zonën Gjeografike (NZGJ) 18 (Adriatiku i Jugut).

Flota detare shqiptare nisur nga qëllimi i anijes ndahet në gjashtë lloje të ndryshme anije peshkimi:

Me tërheqje (fundore dhe pelagjike) - metoda e peshkimit më e rëndësishme dhe një nga më efikasat në botë është ajo me tërheqje. Kjo metodë kryhet si në ujëra të cekëta dhe deri në thellësi 2000 m. Rrjetat tërheqëse përdoren për peshkim fundor dhe pelagjik, në varësi të formës së rrjetës të përdorur. Procesi i tërheqjes kryhet për një periudhë të caktuar kohe dhe për një distancë të caktuar, deri në tërheqjen e rrjetës lart dhe zbrazen e saj. Ky mjet peshkimi përdoret kryesisht për të peshkuar peshqit fundorë.

Me mreza - Këto anije përdorin rrjeta rrethuese dhe detare dhe përbëjnë një grup të madh të të gjitha madhësive, duke filluar nga anije të hapura, zakonisht të paktën 10 m në gjatësi, deri tek anijet që shkojnë në oqean. Këto zakonisht përdoren për të kapur speciet pelagjike të grumbulluara.

Me koshilok - Përbëjnë një grup anijesh duke përfshirë mjete me të gjitha madhësitë, duke filluar nga varka të vogla deri tek anijet që peshkojnë në oqean. Koshilokët janë mjetet më të rëndësishme dhe më efektive për të zënë specie që grumbullohen pranë sipërfaqes. Mjeti rrethon tufën në anë të rrjetës, më pas pjesa e poshtme e saj mbyllet (nën tufë) me anë të një litari, i cili nisat nga anija, kalon përmes unazave në fund të rrjetës dhe përsëri në anije.

Me draga hidraulike - Dragat janë mjete që gërryejnë fundin e detit për molusqe bivalvë. Dragat përbëhen nga një konstrukt metalik në të cilin kapet thesi i ndërtuar nga unaza metalike ose rrjetë. Dragat mund të tërhiqen me anije ose me krahë. Dragat janë mjete që përdoren në bregdetin e afërt dhe peshkojnë duke qenë në kontakt të fortë me tabanin.

Me njica - Madhësia e anijeve ndryshon në lidhje me zonën e gjuetisë. Këto mjete mund të jenë nga varka të vogla për ujërat e brendshme dhe në bregdet, anije të vogla në kuvertë në ujërat bregdetare dhe anije të mesme që peshkojnë në det të hapur. Në ujërat bregdetare është shumë e zakonshme që kjo formë peshkimii të përdoret si një metodë sekondare sipas sezonit të peshkimit dhe specieve target.

Anije shumëpërdorimshe - mjete peshkimi të cilat përdorin në menyrë të alternuar dy ose më shumë vegla peshkimi pa modifikime të mëdha në anije.